



Pranimi / Doretimi Prilipi / Prilipi Received / Delivered	16 - 03 2022	2 viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Shërbimi Org. / Unit	SKOMSHOK	
Nr. Prot. Pr. No.	1418/2022	
Shtojca Prilipi Appendix		Sasia Kolicina Quantity
		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.77/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtar, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.77/2022 të datës 01.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] nga [redacted] kundër Vendimi KA.nr.66/2021 me numër të protokollit 01/3013 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.77/2022 e datës 01.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me numër KA.nr.63/2021 me numër të protokollit 01/3013 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm me Nr.03/2021 për vendin e punës "Referent i Lartë" për 2 (dy) pozita në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega Klinë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

I pa kënaqur me njoftimin me numër të protokollit 03/1809 të datës 09.11.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve, ankuesi me datë 07.12.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 31.12.2021 me numër të protokollit 01/3013 merr Vendim me numer KA.nr.63/2021 me të cilin vendim e refuzon si e pa bazuar ankesën e ankuesit

Ankuesi [redacted] kundër Vendimit me numër KA.nr.63/2021 me numër të protokollit 01/3013 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 28.01.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës, të cilën ankesë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar me datë 01.02.2022 me numër protokollit 437/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.02.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 01.03.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/155.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 01.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e ankuesit e datës 08.02.2022 për ndalimin e ushtrimit të detyrës së pozitës Referent i Lartë; Vendimi i datës 31.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 07.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Njoftimi i datës 09.11.2021 për përzgjedhjen përfundimtare; Propozimi i datës 09.11.2021 për emërimin e kandidatëve; Raporti final i rekomandimit i datës 09.11.2021 nga Komisioni Rekrutues; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Raporti mbi përgatitjen e listës së ngushtë; Deklarata për mosekzistimin e konflikt të interesit e datës 25.10.2021 nga anëtarët e komisionit rekrutues; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Lista e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim e datës 03.11.2021; Konkursi i datës 20.05.2021; Përmbledhja e vlerësimeve nga testi me shkrim dhe me gojë për ankuesin [redacted] Form.MAP-SHCK-08a; Testi me shkrim; Kërkesa për punësim i ankuesit [redacted] me numër 394/21 me dokumentacionin e bashkangjitur; Përmbledhja e vlerësimeve individuale të testimit me shkrim dhe me gojë e kandidatit [redacted] Form.MAP-SHCK-08a; kërkesa për punësim e kandidatit [redacted] me numër 5091/21 me dokumentacionin e bashkangjitur; Përmbledhja e vlerësimeve individuale nga testimi me shkrim dhe me gojë për kandidaten [redacted] Form.MAP-SHCK-08a; Kërkesa për punësim e kandidates [redacted] me numër 5081/21 me dokumentacionin e bashkangjitur si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me njoftimin e datës 09.11.2021 për kandidatët e përzgjedhur për vendin e punës „Referent i Lartë“ në Gjykatën Themelore Pejë-Dega Klinë, i cili pretendon se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës dhe kualifikimit në krahasim me kandidatet e suksesshëm si dhe rezultatet e testit me shkrim dhe të intervistës me gojë, sepse ankuesi pretendon se në testim me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me më pak pikë nga komisioni përzgjedhës, gjegjësisht ai pretendon se e gjithë procedura e rekrutimit ka qenë e parregullt dhe e paligjshme .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 20.05.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vendin e punës "Referent i Lartë" Gjykata Themelore Pejë-dega Klinë, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë universitare: Fakulteti Juridik;*
- *Dy (2) vite përvojë pune.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidatët e pranuar nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, dhe pas shqyrtimit të të gjithave dëshmime për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatëve të përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse, kandidatët e përzgjedhur dhe ankuesi janë përfshirë në listën e ngushtë dhe Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i ka vlerësuar drejtë dhe në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 nënparagrafi 1.2 neni 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: "*Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës", secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura te tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankuesit se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës në krahasim me kandidatet e përzgjedhura, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse kandidatët e përzgjedhura kanë përvojë të punës të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës 20.05.2021 siç është kërkuar *Diplomë universitare: Fakulteti Juridik; dy (2) vite përvojë pune*, sepse kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës, "*Referent i Lartë*" në Gjykatën Themelore Pejë-Dega Klinë: _____, e ka të kryer Fakultetin Juridik dhe ka diplomuar me datë 15.06.2015 në Universitetin e "Haxhi Zekaj" në Pejë si dhe në bazë të dëshmime në dosje e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës sipas referencës të lëshuar nga Kosova Tours SHPK _____ nga muaji prill i vitit 2016 gjer më 05.09.2017 ka qenë në venin e punës "*Juriste*" dhe sipas vërtetimit të performancës së punës të datës 24.12.2019 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit të Agjencisë Kundër Korrupsion vërtetohet se _____ nga data 01.06.2018 gjer më datën 31.12.2019 ka qenë praktikante në Departamentin për Parandalimin e Korrupsionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa kandidati i përzgjedhur _____ e ka të kryer Fakultetin Juridik dhe ka diplomuar me datë 10.09.2014 në Universitetin e "Haxhi Zekaj" në Pejë si dhe në bazë të dëshmime në dosje e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës sipas certifikatës së datës 06.01.2017 me numër I.A.GJ.nr.12/17 të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës në Pejë, _____ ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti nga data 05.01.2016 gjer më datën 04.01.2017 dhe sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar ka qenë në marrëdhënie pune me _____ nga data 01.06.2019 gjer më datën 01.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në listë të ngushtë ka përfshirë edhe ankuesin dhe kandidaten e përzgjedhur sepse i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 20.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili e ka pretenduar se testi me shkrim nuk ka qenë në përputhje me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës respektivisht gjatë shqyrtimit të testit me shkrim për pozitën e lartcekur ka konstatuar, se në pajtim me kriteret e konkursit, testi me shkrim ka qenë i ndarë në tri (3) pjesë, ku në pjesën e parë (pjesa e njohurive të përgjithshme, kandidatëve u parashtrohen 3 deri në 5 pyetje në formë eseje) kandidatëve u janë parashtuar tri (3) pyetje me përgjigje në formë eseje, në pjesën e dytë (pjesa e aftësive të përgjithshme dhe personalitetit, në këtë pjesë kandidatëve u parashtrohen 10 deri 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta) kandidatëve u janë parashtuar dhjetë (10) pyetje me përgjigje të shumëfishta ndërsa në pjesën e tretë (pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës, kandidatëve u parashtrohen 15 deri 23 pyetje, prej të cilave janë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% në formë eseje) kandidatëve u janë parashtuar gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, ku shtatë (8) prej tyre ishin me përgjigje të shumëfishta ndërsa tetë (8) tjera me përgjigje në formë eseje, në këtë kuptim testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka pretenduar se kandidatja e përzgjedhur [redacted] ka konflikt interesi me [redacted] e cila punon si Zyrtare e Lartë për Prokurim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, respektivisht është në lidhje familjare sepse ai pretendon se ajo është halla e saj, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton për raste të tilla duhet të ketë një vendim me shkrim nga organet kompetente të cilat bëjnë interpretimin e konflikt interesit.

Kolegji i Këshillit për shqyrtimin e ankesave, nga provat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidatët e përzgjedhur [redacted] nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 434 pikë dhe kandidati [redacted] nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 407.5 pikë ndërsa ankuesi [redacted] nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 276.25 pikë dhe është ranguar i katërmëdhjetë (14) në listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.63/2021 me numër të protokollit 01/3013 i datës 31.12.2021, ka vepruar në pajtim me



dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.77/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.